



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 39/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Graniti Sh.p.k.", me numër të protokollit 39/23, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar për salla të gjykimeve dhe zyra të shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr prokurimit nr. 328-22-12042-1-1-1; nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datën 19.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Graniti Sh.p.k." me numër të protokollit 39/23, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me inventar për salla të gjykimeve dhe zyra të shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr prokurimit nr. 328-22-12042-1-1-1, nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- 2. Mbetet në fuqi**, vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me inventar për salla të gjykimeve dhe zyra të shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr prokurimit nr. 328-22-12042-1-1-1, nr. i brendshëm 33300/022/038/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

3. Meqenëse refuzohet si e pabazuar, i bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, konform nenit 31 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.12.2022, AK- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar për salla të gjykimeve dhe zyra të shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr prokurimit nr. 328-22-12042-1-1-1; nr. i brendshëm 33300/022/038/111.

Data e hapjes së ofertave: 13.12.2022, Njoftimi mbi vendimin e AK-se: 29.12.2022, Kërkesa për rishqyrtim: 04.01.2023. Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 05.01.2023.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 24. 01. 2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa të refuzohet si e pabazuar,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës

Pretendimin ankimor 1

OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm për faktin se NUK ka prezantuar katalog dhe specifikacion teknik konform kërkesës së dosjes së tenderit. OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar vetëm foto dhe ato foto i ka kopjuar bashke me specifikimet nga dosja e tenderit, pra ka vendosur foto të marra nga dosja e tenderit. Andaj ky fakt tregon qartë se OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se nuk e ka prezantuar katalogun konform kërkesës së dosjes së tenderit, mirëpo fotot i ka kopjuar nga dosja e tenderit, ku ky fakt vërtetohet shumë lehtë nëse analizohet oferta e OE të rekomanduar për kontrate, mirëpo AK haptas ka bërë favorizime.

Përgjigjja në pretendim 1

Në pretendimin ankimor të kompanisë ankuese “Graniti shpk” së AK-Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka rekomanduar kompaninë “Mobelland shpk” pa i plotësuar kriteret e vlerësimit të përcaktuar në dosjen e tenderit. Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar kriterin e vlerësimit të shpallur në dosjen e tenderit: Kërkesa- Inventari të dëshmohet me fotografi për secilin artikuj (përjashtimisht sallave të gjyqimit dhe zyrave të shkrimoreve) konstaton se kërkesa- kriteri i vlerësimit të tenderit nuk është kërkuar katalog i forte apo katalog prodhuesi por është kërkuar që të dorëzohen fotografi të inventarit që është kërkuar në dosjen e tenderit për secilin artikull në bazë të fakteve që i kemi analizuar kompania e rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kriterin e kërkuar nga AK-ja. Kërkesa e dosjes së tenderit është kërkuar që të dorëzohen fotografi të inventarit për artikujt dhe kompania e rekomanduar për kontrate ka dorëzuar fotografi të inventarit ashtu siç e ka qenë kërkesa në dosjen e tenderit.

Prandaj duke marrë për bazë nenin 59 të LP-së është në diskrecion të AK –së të gjitha dokumentet e kërkuara dhe që janë vendosura në dosjen e tenderit, duhet të jenë drejtpërdrejt relevant dhe proporcionale në raport me kriteret e vlerësimit dhe për këtë kompania e rekomanduar për kontrate dokumentet që kanë dorëzuar në oferte janë proporcional me kriterin e vlerësimit.

Gjithashtu kompania e rekomanduar për kontrate ka dorëzuar deklaratën e specifikimeve teknike ku ka deklaruar se mallra që do të furnizon do të jenë në përputhje me specifikimin teknik të kërkuar në dosjen e tenderit me këtë ekspert shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pa bazuar, e AK-ja lidhur me këtë pretendim në plotëni ka respektuar nenin 59 të LPP-së.

Sa për Informimin e panelit shqyrtues unë si ekspert mendoj se dëshminë e dorëzuar – katalogun që është si pretendim ankimor i kompanisë ankuese është përafërsisht i njëjti i të dy kompanive asaj të rekomanduar dhe kompanisë ankuese, vetëm kompania ankuese e ka me ngjyra. Mirëpo kërkoj nga paneli shqyrtues të vërtetojë dhe të krahasoj vetë pasi katalogu të dy kompanive është i printuar si katalogu.

Pretendimin ankimor 2

OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar edhe me çmime jo normalisht te ulte, ndërsa te disa produkte ka ofruar çmime shumë më të larta se sa çmimet e tregut, prandaj rezulton se ky OE ka ofertuar me çmime manipulative.

Përgjigjja në pretendim 2

Artikujt që janë të grumbulluar në një tabelë dhe janë të poentuar me përqindje nuk mundet të cilësohen si çmime manipuluese pasi përqindja prej (45% Te Pikëve tabela e listave të çmimeve) e poentuar i përfron me çmim konkurrent të tregut dhe ligji nuk njeh në këtë procedurë si çmime manipulative pasi AK i ka poentuar tabelat e artikujve përqindjen me të madhe apo me të vogël varësisht ku e ka pas interesin AK-ja të marrë çmime me të favorshme në interesin e AK-se.

Pra sa më e madhe është vlera e një artikulli kur përpjesëtohet me 45% zbritja në çmim është më e madhe.

Sipas RRPP nënitet 17.35 AK të kontratës me çmime për njësi AK duhet të përcaktoj peshën në baze të rëndësishme të secilës kategori të artikujve ose grup të artikujve në atë mënyrë që AK –se të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit dhe në baze të kësaj AK-ja ka vepruar në përputhje me LPP-në e i ka barazuar të gjithë OE.

Gjithashtu në baze të nënitet 61 të LPP-se për çmime jo-normalisht të ulët është në kompetencën e AK-se dhe ka të drejtën e të vendosë për të sqaruar për çmime jo-normalisht të ulët me OE, kur ai e parashihet se çmimet janë shumë të ulta dhe ka rrezik për mos realizim të kontratës. Tenderët jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, në këtë rast për AK-në çmimet kanë qenë të besueshme.

OE i rekomanduar për kontrate “Mobelland shpk” në këtë rast është si OE prodhues dhe çmimet e një prodhuesi për mallrat që i prodhon vetë dhe i shet vetë çdo herë mundohet të del në treg me çmime me të favorshme se çmimet e mallrave tregtare apo mallrave që importohen nga jashtë . Kjo në ekonomi njihet si politike e çmimeve që prodhuesit vendore dëshirojnë të mbizotërojnë mbi çmimet tregtare.

AK-ja e ka parapa për këtë arsye i ka grupuar artikujt e i kanë peshuar që mos me pas kështu manipulime të çmimeve dhe në baze të fakteve të krahasuara ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi ankimore është i pa bazuar.

Pretendimi 3

Në nënitet 9.1&9.2 të FDT është kërkuar "Ofertuesi duhet të ofroj dëshmi se ka kontratë apo kontrata të përfunduara furnizim me inventar në tri vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontratë, vlera e përgjithshme monetare e furnizimeve për operatorin ekonomik ose grupin e operatoreve ekonomik jo më të vogël se: gjashtëqind mijë Euro; 600,000.00 €, kurse si dëshmi dokumentare është kërkuar "Lista e kontratave të realizuara së bashku me

referenca. Ose raportin e pranimit nga komisioni ku ne raport konstaton se kontrata është përmbyll ne tersi nga data e hyrjes ne fuqi deri ne datën e përmbylljes ne kohëzgjatje prej Vite, Muaj , Dite.

OE nuk ka prezantuar kontrata për referencat e ofruara, kurse kontratat janë te viteve 2018 dhe 2019, ndërsa referencat i ka te vitit 2021!!!! prandaj këto dëshmi nuk mund dhe nuk duhet te merren parasysh, A.K është dashur MOS e favorizoj O.E.

Përgjigjja ne pretendim 3

Ne baze te listës se Referencave qe ka dorëzuar me oferte kompania e rekomanduar për kontrate shifet qarte se është plotësuar kërkesa e dosjes se tenderit qe është kërkuar ne piken 9.1/9.2 te FTD. Ne baze te nenit 69 te LPP-se, Autoriteti kontraktues duhet të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe këto kërkesa minimale duhet te specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë nga autoriteti kontraktues për OE, atëherë OE janë te obliguar te plotësojnë kërkesat minimale te kërkuara dhe këto kërkesa minimale i ka plotësuar OE i rekomanduar për kontratë sipas ekspertit shqyrtues. Shikoni vete këto te tria e plotësojnë kushtin e kërkuar.

Inventarizimi i Dekanatit te F. Mjekësisë dhe njësive tjera te UP-se	Universiteti i Prishtinës	22.11.2019 22.11.202.	242-19-8174-111	412,402.51 euro
Furnizim me inventar ne bibliotekë dhe hapësira tjera te Objektit UMB	Universiteti i Mitrovicës	25.03.2020 24.06.2020	97900-19-7261-121	123,450.32 euro
Furnizim me Inventar për shkollat e arsimit para universitar.	Ministria e Arsimit	09.07.2020	208-19-7223-111	528,000.00 euro

Ne baze te këtyre fakteve dhe dëshmive ne oferte e OE te rekomanduar për kontrate eksperti shqyrtuese konstaton se pretendimet e kompanisë ankuese “Graniti shpk” janë te pabaza.

Pretendimi 4

Duke u bazuar ne te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken me larte konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është here ne harmoni me nenin 59 te LPP-se, sepse është rekomanduar pe kontrate OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës e qe ka qene tenderi përgjegjshëm me çmim me te ulet te peshuar, pra nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënie te kontratës sipas nenit 60 te LPP-se.

Përgjigjja ne pretendim 4

Ne baze te raportit te Hapjes se ofertave shihet se kompania e rekomanduar është me çmim me te ulëte por këtë e ka vërtetuar edhe komisioni i vlerësimit i cili ne përputhje me nenin 59 te LPP-se ka bere vlerësimin e ofertave dhe ka rekomanduar për kontrate kompaninë me çmim me te ulet.

Ne baze te kësaj eksperti shqyrtuese konstaton se pretendimi ankimore se nuk është respektuar neni 59 dhe neni 60 i LPP-se është i pa bazuar.

Pretendimi 5

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka dorëzuar edhe vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa ne nenin 6.4 te FDT-se është kërkuar - Vërtetimi i ATK duhet të jetë origjinal me bar kod, dokumenti dorëzohet pranë AK-se para njoftimit mbi vendimin e AK-se. Ne rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi (oferta) në fjale datë refuzohet"

Përgjigjja në pretendim 5

Ne baze të LPP-se nenit 68 Vërtetimi Tatimore duhet të jetë tremujorin e fundit që është kërkuar në këtë rast. Vërtetimi tatimore duhet me qene jo më i vjetër se TM3, pra OE mundet ta dorëzojë në ATK -TM3 ndërsa sa i përket Vërtetimit të gjykatës ky vërtetim nuk duhet të jetë më i vjetër se gjashtë (6) muaj. Ne baze të dokumenteve që ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontrate këto dokumente e plotësojnë kriterin e kërkuar dhe pretendimi ankimor është i pa bazë.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-se, sepse na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-se dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-se e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente ", mirëpo ju nuk jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Përgjigjja në pretendim 6

Gjatë analizimit të Raportit të Vlerësimit të ofertave dhe gjithë aktivitetit të Prokurimit eksperti shqyrtues mendon se është bërë Vlerësimi i ofertave në përputhje me LPP-në saktësisht nenin 7 dhe nuk është diskriminuar asnjëra kompani konkurruese por as kompania ankuese që ka pretenduar se është diskriminuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave. Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se kompania ankuese nuk ka cek në ankese asnjë dëshmi/fakt se ku ju është bërë diskriminimi vetëm pretendon se ka qene kompania e përgjegjshme është dashur të rekomandohet për kontratë në këtë tender. AK-ja sipas raportit të vlerësimit dhe B58 -Letrave standarde OE ankues "Graniti shpk" është si OE i pa suksesshëm dhe AK-ja ka vepruar në përputhje me LPP-në se kompania e rekomanduar për kontratë ka çmimin më të ulët konkurrues që vërehet se AK-ja ka respektuar nenin 1 , 6 që kompania ankuese "Graniti shpk" ka pas si pretendim ankimor në ankesë dhe në baze të fakteve dhe dëshmive konstatoj si eksperte shqyrtues se pretendimi ankimor është i pa bazë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 24 janar 2023 me raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues "Graniti", ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast.

Pretendimi i parë i OE është për OE të rekomanduar duke theksuar se i njëjti nuk ka prezantuar katalog dhe specifikacion teknik krahas kërkesës se dosjes se tenderit, ndërkaq paneli shqyrtues konstaton se Kërkesa- Inventari të dëshmohej me fotografi për secilin artikuj (përjashtimisht sallave të gjykitimit dhe zyrave të shkrimoreve) është plotësuar sepse nuk është kërkuar katalog i forte apo katalog prodhuesi por është kërkuar që të dorëzohen fotografi të inventarit që sipas dosjes së tenderit për secilin artikull dhe OE i rekomanduar e ka plotësuar këtë kërkesë sepse kërkesa ka qenë që të dorëzohen fotografi të inventarit për artikujt dhe kompania e rekomanduar për kontratë ka dorëzuar fotografi të inventarit ashtu siç e ka qenë e specifikuar.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, ngase të disa produkte ka ofruar çmime shumë më të larta se sa çmimet e tregut, duke ofertuar me çmime manipulative, vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, sepse artikujt janë të poentuar me përqindje dhe po thuajse të gjitha ofertat pëmbajnë çmime të cilat diku janë më të larta e diku më të ulëta, andaj në këtë rast PSH mbështet vendimin e AK-së dhe konstaton se përgjegjësia e zbatimit, menaxhimit dhe vlerësimit të çmimeve (sidomos manipulative nëse evidentohen) qëndron në përgjegjësinë e plotë të AK-së.

Sipas nenit 17.35, të RrPP-së, AK të kontratat me çmime për njësi duhet të përcaktojnë peshët në baze të rëndësisë së secilës kategori të artikujve ose grup të artikujve në atë mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Komisioni për ekzaminim, krahasim dhe vlerësim të ofertave sipas shkresave nuk i ka klasifikuar si çmime normalisht të ulëta kjo me siguri ka ndodhur për shkak se edhe OE ankues brenda ofertës së tij përmban çmime të cilat nuk janë çmime të tregut. Përcaktimi i çmimit të tregut për këtë kategori është shumë e vështirë për shkak se OE mund të jetë prodhues vendor dhe çmimet e një prodhuesi për mallrat që i prodhon vete dhe i shet vete çdo herë mundohet të del në treg me çmime më të favorshme se çmimet e mallrave tregtare apo mallrave që importohen nga jashtë.

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar nuk ka prezantuar kontrata për referencat e ofruara, kurse kontratat janë të viteve 2018 dhe 2019, ndërsa referencat i ka të vitit 2021, paneli shqyrtues sqaron se në nenin 9.1&9.2 të FDT është kërkuar "Ofertuesi duhet të ofroj dëshmi se ka kontratë apo kontrata të përfunduara furnizim me inventar në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, vlera e përgjithshme monetare e furnizimeve për operatorin ekonomik ose grupin e operatoreve ekonomik jo më e vogël se: gjashtëqind mijë (600,000.00

e). Duke bërë krahasimin e kërkesës së dosjes së tenderit, dhe dokumentacionit të ofruar nga OE i rekomanduar (të paraqitur në formë tabelare nga eksperti shqyrtues), paneli shqyrtues arrinë të vlerësojë saktë se kjo kërkesë është përmbushur sepse nga tri (3) kontratat që ka ofruar OE “Mobelland” 412K+ 123K+ 528K, arrihet vlera mbi një (1) milion, andaj pretendimi është i paqëndrueshëm.

Paneli shqyrtues vlerëson gjithashtu se edhe pretendimi ankimor për shkelje të nenit 59 të LPP-së është i paqëndrueshëm, sepse në rastin konkret në vlerësim të kësaj procedure të prokurimit, komisioni vlerësues i AK-së ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili është teknikisht dhe ekonomikisht me i favorshëm, duke vepruar në përputhshmëri me kriterin e dosjes së tenderit që të rekomandohet një tender që është administrativisht dhe teknikisht i përgjegjshëm dhe ekonomikisht i favorshëm.

Operatori ekonomik ankues në ankesë ka pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka dorëzuar edhe vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa në nenin 6.4 të FDT-së është kërkuar - Vërtetimi i ATK duhet të jete original me bar cod. Paneli shqyrtues duke u bazuar në mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues sqaron se në baze të nenit 68 të LPP-së, vërtetimi tatimor duhet të jete për tremujorin e fundit, pra OE mundet ta dorëzojë në ATK -TM3 ndërsa sa i përket vërtetimit të gjykatës ky vërtetim nuk duhet të jete me i vjetër se gjashtë (6) muaj. Paneli shqyrtues duke u bazuar në konstatimin e ekspertit shqyrtues thekson se në baze të dokumenteve që ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë këto dokumente e plotësojnë kriterin e kërkuar dhe pretendimi ankimor, është i paqëndrueshëm.

Paneli shqyrtues vlerësoj edhe pretendimin për shkelje të nenit 7 të LPP-së dhe konform mendimit të ekspertit shqyrtues thekson se nuk është diskriminuar asnjëra kompani konkurrese por as kompania ankuese që ka pretenduar se është diskriminuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave. Gjithashtu, OE ankues nuk ka çekur në ankesë asnjë dëshmi/fakt se ku ju është bërë diskriminimi.

- Përfundim -

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër, Paneli konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP, sepse në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik. Ankuesi ka theksuar në vijim se cituar: “...ky veprim përbën shkelje të plotë edhe të nenit 1 dhe 6 të LPP-së duke tentuar të bëjë shfrytëzim jo efikas dhe jo transparent të parasë publike dhe duke tentuar që mjetet financiare të i shfrytëzojë në mënyrën më jo ekonomike të mundshme”. Mirëpo nga shqyrtimi i shkresave të kësaj lënde dhe i rrjedhës së prokurimit, Paneli nuk gjeti ndonjë provë sipas së cilës mund të konstatohet synimi i AK për shfrytëzim jo efikas dhe jo transparent të parasë publike. Ankuesi ka pohuar më tej se AK ka shkelur nenin 10 (Mjetet për promovimin e Transparencës) të LPP, mirëpo edhe në këtë rast, bazuar paraprakisht në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se nuk ka shkelje në dispozitës së cituar, pa nevojë për ti përsëritur shpjegimet si më sipër.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Prandaj duke ju referuar nenit 104 të LPP, dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shpjegojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Po ashtu, Paneli shqyrtues konstaton edhe sikur ankesa të aprovohej si e bazuar, prapë do të vijë te një gjendje e njëjtë ku do të duhet të refuzohej edhe oferta e ankuesit për shkak të çmimeve të ofruara.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK-së
- 1x1 OE "Graniti"
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.